


Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Gusht 2020

Tiranë, më 08 Shtator 2020: Indeksi i Çmimeve të Konsumit në muajin Gusht 2020, arriti 107,8 kundrejt muajit Dhjetor 2015.

Ndryshimi vjetor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2020 është 1,3 %. Një vit më parë ky ndryshim ishte 1,4 %. Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të konsumit në muajin Gusht 2020, krahasuar me Korrik 2020, është 0,2 %.


Fig. 1 Ndryshimet vjetore të Indeksit të çmimeve të konsumit (%)



Ndikimi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të indeksit të çmimeve të konsumit. Rritja vjetore e çmimeve në muajin Gusht është ndikuar kryesisht nga grupi “Ushqime dhe pije joalkoolike” me +1,14 pikë përqindje, pasuar nga grupi “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me +0,31 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” kanë kontribuar me +0,12 pikë përqindje. Çmimet e grupit “Mallra dhe shërbime të ndryshme” kanë kontribuar me +0,04 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Pije alkoolike dhe duhan” dhe “Hotele, kafene dhe restorante” kanë kontribuar me +0,02 pikë përqindje secili. Çmimet e grupeve “Komunikimi” dhe “Shërbimi arsimor” kanë kontribuar me +0,01 pikë përqindje secili. Çmimet e grupit “Transporti” kanë kontribuar me -0,39 pikë përqindje. Çmimet e grupeve “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” kanë kontribuar me -0,01 pikë përqindje secili.

Për publikim 08/09/2020

Fig. 2 Ndikimi i grupeve në ndryshimin vjetor



Ndryshimet vjetore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Gusht 2019, rritja më e madhe e çmimeve vërehet në grupin “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 3,1 %, pasuar nga grupet “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” me 1,9 %, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” me 1,5 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Hotele, kafene dhe restorante” dhe “Mallra dhe shërbime të ndryshme” me 0,6 % secili, “Komunikimi” me 0,5 % dhe “Shërbimi arsimor” me 0,2 %. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Transporti” u ulën me 5,8 %, pasuar nga grupet “Veshje dhe këpucë” dhe “Shëndeti” me 0,2 % secili.

Brenda grupit të ushqimeve, çmimet e nëngrupit “fruta” u rritën me 14,3 %, pasuar nga nëngrupet “vajra dhe yndyrna” me 4,7 %, “peshk” dhe “sheqer, recel, mjaltë, çokollata, dhe ëmbëlsira” me 3,6 % secili, “qumësht, djathë dhe vezë” me 2,3 %, etj.

Ndryshimet mujore të grupeve kryesore: Krahasuar me muajin Korrik 2020, çmimet e grupeve “Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë” dhe “Transporti” u rritën me 0,5 % secili, pasuar nga grupet “Ushqime dhe pije joalkoolike” me 0,4 %, “Pije alkoolike dhe duhan”, “Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji” dhe “Argëtim dhe kulturë” me 0,1 % secili. Nga ana tjetër çmimet e grupit “Veshje dhe këpucë” u ulën me 0,3 %.

Tab. 1 Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Dhjetor 2015=100

Kodi	Grupet	Peshat	08-19	09-19	10-19	11-19	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20
	Gjithsej	100	106,5	106,6	106,4	106,2	107,1	109,1	109,5	110,2	109,7	108,8	108,1	107,6	107,8
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	37,3	111,8	112,2	111,7	111,2	113,4	118,4	119,5	121,7	120,5	118,0	116,3	114,7	115,2
2	Pije alkoolike dhe duhan	3,4	104,9	104,9	104,8	104,9	104,6	105,2	105,3	105,5	105,3	105,4	105,4	105,5	105,6
3	Veshje dhe këpucë	3,6	98,5	99,1	99,4	99,6	99,7	99,6	99,4	98,9	98,9	98,3	98,6	98,6	98,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	20,9	105,1	105,1	105,2	105,2	105,4	106,8	106,8	106,8	106,7	106,8	106,6	106,5	106,6
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	6,4	100,8	100,9	101,0	101,2	101,4	101,3	101,3	101,5	102,6	102,4	102,4	102,2	102,7
6	Shëndeti	3,5	99,5	99,6	99,5	99,4	99,4	99,2	99,1	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3	99,3
7	Transporti	6,3	104,5	102,9	102,2	102,1	102,8	102,7	102,5	100,3	98,6	97,9	97,8	97,9	98,4
8	Komunikimi	3,0	101,3	101,2	101,2	101,2	101,2	101,0	101,0	100,9	100,9	101,7	101,7	101,7	101,7
9	Argëtim dhe kulturë	2,4	107,9	108,4	108,0	107,1	107,3	106,8	107,5	107,5	108,4	108,0	108,8	107,9	107,9
10	Shërbimi arsimor	2,9	102,1	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3	102,3
11	Hotele, kafene dhe restorante	3,9	102,3	102,4	102,4	102,5	102,5	102,7	102,8	102,8	102,9	102,8	102,8	102,9	102,9
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	6,3	103,7	103,7	103,8	103,8	103,9	103,9	104,0	103,9	103,8	103,9	104,0	104,3	104,3

Tab. 2 Ndryshimet vjetore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	08-19/08-18	09-19/09-18	10-19/10-18	11-19/11-18	12-19/12-18	01-20/01-19	02-20/02-19	03-20/03-19	04-20/04-19	05-20/05-19	06-20/06-19	07-20/07-19	08-20/08-19
	Gjithsej	1,4	1,3	1,3	1,4	1,1	1,5	1,2	2,1	1,9	2,1	1,8	1,4	1,3
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	2,4	2,5	3,0	3,2	2,6	2,4	1,9	4,6	4,3	4,9	4,1	3,1	3,1
2	Pije alkoolike dhe duhan	1,5	1,5	1,4	1,1	0,2	0,5	0,7	0,8	0,6	0,6	0,6	0,7	0,6
3	Veshje dhe këpucë	0,2	0,2	-0,1	-0,3	-0,2	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,7	-0,5	-0,2	-0,2
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,8	0,7	0,1	0,1	0,1	1,5	1,4	1,7	1,3	1,4	1,4	1,4	1,5
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	1,5	1,5	1,4	1,5	1,2	1,2	0,8	0,9	1,9	1,9	2,0	1,8	1,9
6	Shëndeti	-0,1	0,0	-0,1	0,0	-0,4	-0,6	-0,7	-0,6	-0,7	-0,6	-0,6	-0,2	-0,2
7	Transporti	1,2	-0,6	-2,0	-1,6	0,2	1,5	1,2	-1,5	-3,1	-3,7	-4,0	-4,8	-5,8
8	Komunikimi	0,1	0,1	0,1	0,0	-0,1	-0,3	-0,3	-0,4	-0,3	0,4	0,4	0,5	0,5
9	Argëtim dhe kulturë	2,2	0,5	1,2	2,1	2,2	2,3	2,4	2,4	3,8	2,7	2,9	1,4	0,0
10	Shërbimi arsimor	0,8	0,9	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2	0,2
11	Hotele, kafene dhe restorante	1,1	1,2	1,2	1,3	0,6	0,9	0,8	0,7	0,8	0,7	0,5	0,5	0,6
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,1	0,2	0,3	0,2	0,2	0,1	0,3	0,1	0,0	0,3	0,3	0,6	0,6

Tab. 3 Ndryshimet mujore të Indeksit të Çmimeve të Konsumit

%

Kodi	Grupet	08-19	09-19	10-19	11-19	12-19	01-20	02-20	03-20	04-20	05-20	06-20	07-20	08-20
	Gjithsej	0,3	0,1	-0,2	-0,1	0,8	1,9	0,4	0,6	-0,4	-0,8	-0,6	-0,5	0,2
1	Ushqime dhe pije joalkoolike	0,4	0,4	-0,5	-0,4	2,0	4,4	1,0	1,8	-1,0	-2,1	-1,5	-1,3	0,4
2	Pije alkoolike dhe duhan	0,2	0,0	-0,1	0,0	-0,2	0,6	0,1	0,1	-0,2	0,1	0,1	0,1	0,1
3	Veshje dhe këpucë	-0,2	0,6	0,4	0,1	0,1	-0,1	-0,2	-0,5	-0,1	-0,5	0,3	0,0	-0,3
4	Qira, ujë, lëndë djegëse dhe energji	0,1	0,0	0,1	0,0	0,2	1,3	0,0	0,0	-0,1	0,0	-0,2	0,0	0,1
5	Mobilje, pajisje shtëpie dhe mirëmbajtje e shtëpisë	0,4	0,1	0,0	0,2	0,2	-0,1	0,0	0,2	1,1	-0,1	0,0	-0,2	0,5
6	Shëndeti	0,0	0,1	-0,1	-0,1	0,0	-0,2	-0,1	0,3	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
7	Transporti	1,6	-1,5	-0,7	-0,1	0,6	0,0	-0,2	-2,2	-1,7	-0,7	-0,1	0,1	0,5
8	Komunikimi	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	-0,2	0,0	-0,1	0,0	0,8	0,0	0,0	0,0
9	Argëtim dhe kulturë	1,5	0,4	-0,3	-0,8	0,2	-0,5	0,6	0,0	0,8	-0,4	0,8	-0,9	0,1
10	Shërbimi arsimor	0,0	0,2	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0	0,0
11	Hotele, kafene dhe restorante	0,0	0,1	0,0	0,1	0,0	0,3	0,0	0,0	0,1	0,0	0,0	0,0	0,0
12	Mallra dhe shërbime të ndryshme	0,0	0,0	0,1	-0,1	0,1	0,0	0,1	-0,1	-0,1	0,1	0,1	0,3	0,0

Informacion

Mbledhja e të dhënave për IÇK është ndikuar nga kriza COVID-19 në të gjitha vendet. INSTAT gjatë kësaj periudhe ka ndjekur rekomandimet më të fundit metodologjike të EUROSTAT dhe të partnerëve të tjerë ndërkombëtarë.

Institutet Kombëtare të Statistikave dhe Eurostat kanë rënë dakord për një sërë procedurash për të vlerësuar çmimet që nuk mund të mblidhen për shkak të kufizimeve të lëvizshmërisë ose mbylljes së njësive tregtare.

Metodologjia

Ndryshime metodologjike

Në muajin Janar të çdo viti Indeksi i Çmimeve të Konsumit shoqërohet me disa ndryshime metodologjike sipas metodologjisë ndërkombëtare të llogaritjes së këtij treguesi, të cilat konsistojnë në:

- Përditësimin e peshave: Peshat e mallrave dhe shërbimeve janë ndryshuar duke u bazuar në shpenzimet mesatare të Anketës së Buxhetit të Familjeve 2018.
- Përditësimin e listës së mallrave dhe shërbimeve: Shporta përbëhet nga 331 produkte dhe shërbime.
- Përditësimin e listës së njësive tregtare ku mblidhen çmimet.

Përkufizime

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) është matësi zyrtar i inflacionit në Shqipëri, Indeksi mat ndryshimet relative të çmimeve të mallrave dhe shërbimeve të përdorura nga familjet për konsum vetjak dhe llogaritet duke përdorur strukturën e konsumit final të familjeve shqiptare. Burimi kryesor i informacionit për shpenzimet është Anketa e Buxhetit të Familjeve.

Ndryshimi vjetor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve midis muajit korrent me të njëjtin muaj të vitit të mëparshëm. Ky ndryshim është rrjedhojë e ndryshimeve korente në nivelin e çmimeve, por mund të ndikohet edhe nga efektet e papërsëritshme të cilitdo muaj.

Ndryshimi mujor mat ndryshimin e indeksit të çmimeve të muajit korrent me muajin e mëparshëm, Ky tregues është i ndjeshëm nga efektet sezonale.

Ndryshimi mesatar 12 mujor mat ndryshimin e indeksit mesatar të konsumit në 12 muajt e fundit me indeksin mesatar të 12 muajve të mëparshëm.